



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.992/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Vali Group” SH.P.K, me seli në rr. “Tirana” Nr. 9 në Prizren, i përfaqësuar nga A.H, avokat në Prizren, kundër debitorit N.T.P. “ METALI “ - Besim B. Sllamniku B.I, me seli në rr. “Tirana” p.n, në Lipjan, i përfaqësuar nga V.Z, avokat në Lipjan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.461/21 të datës 10.06.2021, të Përmbartuesit Privat Mehdi Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 25.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Vali Group” SH.P.K, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.461/21 i datës 10.06.2021, i Përmbartuesit Privat Mehdi Reshani për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,625.00 € (dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë euro) sipas Faturës Nr. 0090 të datës 07.03.2019.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “Vali Group” SH.P.K, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.461/21 të datës 10.06.2021, të Përmbartuesit Privat Mehdi Reshani sa i përket shumës prej 1,550.00 € (njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë euro) sipas Faturës Nr. 0090 të datës 07.03.2019, së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Vali Group” SH.P.K, ndaj debitorit “Vali Group” SH.P.K, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.461/21 të datës 10.06.2021, për shumën prej 2,625.00 € (dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë euro).

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbareim të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbareimor P.nr.461/21 të datës 10.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbareimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 0090 të datës 07.03.2019; duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit shumën prej 4,175.00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareimore nën kërcënimin e përmbareimit të dhunshëm, ndërsa nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin, kreditori propozon që të realizohen përmes zbatimit të përmbareimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogaritjen e veçantë bankare të Zyrës Përmbareimore dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbareimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, në tërë masën pasurore të debitorit, derisa të kryhet tërësisht obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se propozimi i kreditorit është parashkuar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD) dhe se kreditori e ka humbur të drejtën të kërkoj përmbushjen e borxhit në procedurë përmbareimore. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbareimor, si dhe të obligohet kreditori që t’i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk mbështet në prova materiale të cilat kërkohen konform dispozitave ligjore dhe se i njëjti me vetë faktin se nuk e ka kundërshtuar borxhin vërtetohet fakti se borxhi ekziston. Më tej ka shtuar se pretendimi i debitorit se kërkesa lidhur me borxhin është parashkuar konform nenit 360 të LMD-së nuk qëndron, ngase për faturat komerciale sipas LMD-së parashkruhen për 3 vite dhe se afati i përgjithshëm sipas nenit 352 të LMD është 5 vjet. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhri Përmbareimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe

duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përbarimor P.nr.461/21 i datës 10.06.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 0090 të datës 07.03.2019, nga fakti se debitori me parashtrësën datës 10.10.2022, e ka njoftuar gjykatën se lidhur me faturën objekt shqyrtimi në këtë çështje përbarimore e ka përmbushur pjesërisht detyrimin në shumën prej 2,625.00 €, duke ia bashkëngjitur si provë fletëpagesën e datës 13.07.2020 dhe fletëpagesën e datës 31.12.2020, përmes të cilave vërtetohet fakti se debitori në emër të faturës nr. 0090 ka paguar shumën prej 2,625.00 €.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.461/21 të datës 10.06.2021 për shumën e përgjithshme në vlerë prej 1,550.00 €, për faktin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit

1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht – Faturën Nr. 0090 të datës 07.03.2019, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit të debitori si dhe është paguar pjesërisht detyrimi lidhur me këtë faturë.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimin e debitorit se në rastin konkret kërkesa sipas faturës me të cilën është iniciuar propozimi për përmbartim, mbi bazën e të cilës lejuar urdhri përmbartimor është parashkruar konform dispozitave të LMD-së, dhe gjeti se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore, sepse bazuar në dispozitat e nenit 355 par. 1 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se “ *Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, dhe par.2 të po këtij neni me të cilin përcaktohet se “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”, rezulton se kërkesa nga Fatura me nr. 0090, ka filluar të rrjedh prej datës 07.03.2019, ndërsa urdhri përmbartimor është ushtruar me datë 10.06.2021, përkatësisht brenda afatit tri vjeçar të përcaktuar në dispozitën lartcekur.*

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbartuesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbartimor edhe*

sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 1,550.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur fatura është bërë e arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 992/22, datë 25.05.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.